



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI I PAVARUR**  
për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016  
“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

**RAPORT MONITORIMI**

**“MBI**  
**PROCEDURAT QË DUHET TË KRYEJË KLP-JA PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT TË**  
**MANDATIT TË ANËTARËVE TË KLP-SË, PËR TË CILËT JANË VËRTETUAR**  
**KUSHTE TË PAZGJEDHSHMËRISË NË KËTË FUNKSION”**

**I. Baza ligjore që shërben për analizën**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 149 dhe 149/b.
- Nenet 101, 105, dhe 288/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,
- Rregullore e Komisionit të Pavarur, të miratuar me Vendimin e Komisionit nr.3 datë 09.11.2018, e ndryshuar dhe Vendimi i Kuvendit nr.74/2018 “Për ngritjen e komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, pika II/a.

**II. Rezultatet e monitorimit**

Nga Komisioni i Pavarur, referuar njoftimit zyrtar të publikuar në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, konstatohet se më datë 28.02.2019, trupi gjykues i KPA ka disponuar për ndryshimin e vendimit nr.42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit znj.Antoneta Sevdari.

Znj.Antoneta Sevdari, prokurore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është zgjedhur anëtarë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procesverbalit të procesit të votimit, të datës 11.12.2018, të mbajtur në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, të zhvilluar në këtë datë. Zgjedhja e saj është bërë bazuar në nenin 149/2 të Kushtetutës dhe nenin 101/1 të Ligjit nr.115/2016, ku parashikohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, gjashtë prej të cilëve janë prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorisë.

Pozicioni i anëtarit të KLP, (për znj.Sevdari), në momentin e zgjedhjes sa saj dhe më pas gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e KLP-së, ishte i lidhur më detyrën e saj si prokurore. Shkarkimi nga detyra e prokurores i subjektit të rivlerësimit znj.Sevdari, konsiderohet si kusht pazgjedhshmërie si

anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Neni 149/b, pika 1/d e Kushtetutës parashikon mbarimin e mandatit anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur vërtetohen kushte të pazgjedhshmërisë në këtë funksion.

Bazuar në neni 149/b, pika 2 të Kushtetutës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka ushtruar në mënyrë korrekte kompetencat e parashikuar duke deklaruar mbarimin e mandatit me vendim të posaçëm si dhe duke njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm bazuar në nenin 107 të Ligjit nr.115/2016, ka shpallur thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga prokurorët për plotësimin e vendit vakant.

**Për sa më sipër, Komisioni i Pavarur i Monitorimit rekomandon:**

- Prokurorisë së Përgjithshme të vijojë pa vonesa procedurat ligjore për fillimin e procesit të plotësimit të vendit vakant si anëtar i KLP-së duke thirrur Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve.
- Komisioni i Pavarur ka miratuar Raportin përkatës edhe për çështjen e anëtarit të KLP-së, z.Bujar Sheshi dhe i ka përcjellë KLP rekomandimin e posaçëm për rastin, i vlerësuar nga Autoriteti përgjegjës si në kushtet e pazgjedhshmërisë. Duke qenë se në dijeninë e Komisionit të Pavarur, KLP nuk ka asnjë procedurë të nisur, për shqyrtimin e rastit, Komisioni i Pavarur i kërkon Kryetarit të KLP, të përcjellë informacion në lidhje rastin, (parashikuar nga Ligji 115/2016 si në kushtet e pazgjedhshmërisë). Komisioni i Pavarur vëren se Ligji nr.115/2016 e ka referuar të plotë dhe pa pasur nevojë për interpretime, kompetencën për vendimmarrje në raste të pazgjedhshmërisë së një anëtari të KLP. Kur ligjvënësi ka vendosur procedurën për vendimmarrje në këto raste, ka patur parasysh pikërisht një rast si ky, kur kushtet e pazgjedhshmërisë verifikohen jo gjatë fazës së kandidimit, por kur anëtari është në detyrë.

Ky raport i Përcillet

- Komisioni të Ligjeve dhe nëpërmjet tij Kuvendit të Shqipërisë
- Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe
- Prokurorisë së Përgjithshme

Miratuar në datën 28.03.2019

ARTAN SPAHIU

  
KRYETAR

PETRIT PLOÇI

ANËTAR



SAIMIR VISHAJ

ANËTAR



IRENA NINO

ANËTAR



LINDITA RUSMALI

ANËTAR

